



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M
Nr. 22 datë 20.11.2019**

**PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. ELEZ PEPAJ, ZNJ. HANE DYLI, ZNJ. HANE
VIGANI, Z. FIQIRI BECI BANESA E TË CILEVE ËSHTË DËMTUAR NGA
ZJARRI.**

Këshilli i Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës 20.11.2019, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, neni 54 shkronja “dh”, neni 55, pika 2; ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, VKM-së nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB Nr 82 datë 20.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër”, Shkresa me Nr. 3950 Prot., datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme ,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **Z. Elez Pepaj** (2 anëtarë familje), në vlerën prej 40 000 lekë (dyzet mijë), për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **Z. Elez Pepaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 155 026 lekë (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëzet e gjashtë), dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 169 800 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Z. Elez Pepaj**.

3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së Zj. **Hanë Dyli** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 lekë (njëqind mijë), për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e Zj. **Hanë Dyli** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 717 364 lekë (shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tre qind e gjashtëdhjetë e katër), dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 173 000 (njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e Zj. **Hanë Dyli**.
5. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së Zj. **Hanë Vigani** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 lekë (tetëdhjetë mijë), për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.
6. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e Zj. **Hanë Vigani** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 558 680 lekë (pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë), dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 203 600 (dyqind e tre mijë e gjashtëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e Zj. **Hanë Vigani**.
7. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së Z. **Fiqiri Beci** (2 anëtarë familje), në vlerën prej 40 000 lekë (dyzet mijë), për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
8. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e Z. **Fiqiri Beci** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 196 957 lekë (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë), dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 257 760 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e Z. **Fiqiri Beci**.
9. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin P03280 “ Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2019 të miratuar me VKB nr 82. datë 20.12.2018, në programin P03280, O1 A2 “ Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 260 000 lekë.
10. T'i paraqesë dokumentacionin përkatës dhe t'i kërkojë mbështetje Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, Ministrisë Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjen e z. **Elez Pepaj, Zj. Hanë Dyli, Zj. Hanë Vigani, Z. Fiqiri Beci**, sipas përcaktimeve të VKM -së Nr. 329 datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
11. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër për likuidimin e shumës prej 260 000 lekë (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.
12. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
13. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Sekretar i Këshillit

Denis Llesha



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

KRYETARE

Brisela KADIJA



web: www.bashkiashkoder.gov.al

mail: keshilli@bashkiashkoder.gov.al